

VENDIM
Nr.1006, datë 10.12.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS “QEMAL
STAFI”, NË BASHKINË E BILISHTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës “Qemal Stafi”, në bashkinë e Bilishtit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Bilishtit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi e që është pjesë përbërëse e tij për sipërfaqen 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) m² tokë truall, në vlerën e përgjithshme të shpronësimit 183 600 (njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Bilishtit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Bilishtit.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Bilishtit, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë 216 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë) m² tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Bilishtit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Bilishtit për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR NDËRTIMIN E RRUGËS “QEMAL STAFI”, NË BASHKINË E
BILISHTIT**

Nr.	Emër, mbiemër	Sip. truall m²	Çmimi lekë/m²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Hivzi Zyryku	216	850	183 600	232/107	3604
	Totali			183 600		